



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK</u>	Nr Prot Br Prot Prot No <u>03-02/604/17</u>
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Data Datum Date <u>27-02-2017</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.02.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4687/16 për zyrtarin e lartë z. Liridon Drenica, Drejtor për Zhvillimin e Biznesit ne Ndërmarrjen Publike - Trainkos SH.A, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshëm të Konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4687/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Liridon Drenica, Drejtor për Zhvillimin e Biznesit ne Ndërmarrjen Publike - Trainkos SH.A.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Liridon Drenica, Drejtor për Zhvillimin e Biznesit në Ndërmarrjen Publike - Trainkos SH.A. figuron si pronar dhe person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Liridon Drenica, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Ne takimin e organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin z. Liridon Drenica, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar.

z. Drenica, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet dhe nuk ka qenë i informuar se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veprojë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Duke parë që zyrtari i lartë z. Drenica nuk ka sjellë ndryshimet në biznesin AKK-ë i ka dërguar edhe shkresën e detyrues paralajmëruese dhe e ka paralajmëruar që të ndërmerre gjitha veprimet për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të kundërtën do të veprojë konform nenit 18.8 të ligjit nr.04/L-051.

Pas kësaj shkrese, nga z. Liridon Drenica, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Liridon Drenica, nuk figuron me si person i autorizuar dhe pronar në biznesin privat me emër N.T.SH "APEAL" dhe nr.71360687, si dhe deklaratën e tij të dhënë me shkrim.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Liridon Drenica, Drejtor për Zhvillimin e Biznesit në Ndërmarrjen Publike - Trainkos SH.A, dukë bërë ndryshimet e parapara, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar dhe pronar në biznesin privatë janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Liridon Drenica, Drejtor për Zhvillimin e Biznesit në Ndërmarrjen Publike N.P Trainkos SH.A, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

